



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

---

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 27.03.2023,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Bahri Gashi dhe Mirsad Vitia.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Valbona Ahmeti - Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Osman Blaca, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Adelinë Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës dhe Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencat.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues.

Para së të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, kryesuesi informoi se ka marrë një kërkesë prej një qytetari, Adhurim Uka të cilit para disa ditësh i'u është djegur shtëpia në Kodrën e Trimave dhe propozoj që të hyjë si pikë e rendit të ditës, **"Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për z. Adhurim Uka , si pasojë e djegies së shtëpisë"**.

**Bahri Gashi**, shprehi shqetësimin që nuk po përfillet Plani i punës që është miratuar, është fundi i muajit të tretë dhe dy seanca nuk janë mbajtur fare përvèç 3 seancave solemne që i ka mbajtur Komuna e Prishtinës dhe 2 pikave të realizuara prej 16 pikave. Zero është puna e drejtorive e raportimeve po ashtu rapporti i kryetarit që do ta bëjë për tri kontrata është pa lidhje sepse janë 50 lokacione që janë me qira të Komunës së Prishtinës, e kurrë askush nuk e din se a paguajnë apo nuk paguajnë.

**Fehmi Kupina**, dha sqarim se për çdo muaj kërkon prej të gjithë drejtorëve me i sjellë pikat, ato që i sjellin i prezantoj tek ju, kështu që në seancë kur të shkojmë i drejtohesh drejtorëve dhe kryetarit për raport dhe u jep sqarime.

**Gëzim Sveçla**, tha se sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale rendin e ditës e cakton kryetari i Komunës, në bashkëpunim me kryesuesin e Kuvendit, prandaj është plotësisht legjitime kërkesa e Bahriut që edhe nga ju të kërkojmë përgjegjësi, ju jeni njëri ndër dy personat

---

Faqe1nga7

përgjegjës që ka të bëjë me caktimin e rendit të ditës, andaj këtë kërkesë ju duhet me e paraqitë tek kryetari që ne me pas një përgjigje në këtë drejtim.

**Leutrim Retkoceri**, tha se ka një kërkesë që ju është drejtuar nga Shoqata e të Burgosurve Politikë "Lëvizja", ku ata dëshirojnë me e vendosë një pllakë tek mensa e studentëve në shenjë të demonstratave të vitit '81, e kanë dërguar me projekt dhe besoj që deri në seancë do të jenë gati materialet dhe pastaj në seancë e propozoj të vendoset si pikë e rendit të ditës.

Krejt çka kërkojnë nga Komuna e Prishtinës dhe Kuvendi Komunal është ndarja e lokacionit se ku do të vendoset, nëse për seancë do të jenë gati materiali e propozoj të vendoset si pikë e rendit të ditës.

**Fehmi Kupina**, pyeti se kurë e kanë dorëzuar kërkesën.

**Leutrim Retkoceri**, tha se para dy vitesh dhe tani rishtazi e paskan dorëzuar më 11 mars të vitit 2021.

**Bahri Gashi**, pyeti përse nuk ka ndodhë asgjë me këtë qe 2 vite, përse ka mbet nëpër dollapë që 2 vite.

**Fehmi Kupina**, tha se unë nuk jam i njoftuar për këtë kërkesë se çdo kërkesë që vjen nga zyra e kuvendit tek unë të gjitha i protokolloj dhe i adresoj menjëherë se për cilën drejtori është, kështu që nuk ka kërkesë që kalon përmes zyrës time e unë nuk e adresoj.

**Bersant Beka**, propozoj që të hyjë si pikë e rendit të ditës "Informatë lidhur me fillimin e zgjedhjeve të kryetarëve të Këshillave Lokale nga Drejtoria e Administratës".

Kryesuesi konstatoi se me propozimet e dhëna u miratua ky

#### REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale;
3. Raportimi për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;
4. Propozimvendimi për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet;
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës 2023-2025;
6. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për z. Adhurim Uka, si pasojë e djegies së shtëpisë;
7. Informatë lidhur me fillimin e zgjedhjeve të kryetarëve të Këshillave Lokale nga Drejtoria e Administratës;
8. Të ndryshme.

## **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

## **Pika e dytë**

**Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale**

**Fehmi Kupina**, tha se sa i përket raportimit të kryetarit, kryetari nuk ka mundur me ardhur sepse ishte i zënë, kështu që raporton në seancë.

**Nora Kelmendi**, tha se unë e kam dërguar një email dhe e kam kërkuar pikën e rendit të ditës, e kam kërkuar këtë raportim me e pa njëherë për pronat komunale, e kryetari e ka dërguar një raportim me katër paragrafë, se çfarë ka dhënë në shfrytëzim për gjashtë muaj, ku janë ato prona të tjera që i kemi kërkuar para gati një viti për pronat që i ka që nuk e din të kujt janë, që janë prona komunale, a do të raportojë për ato apo jo.

**Leutrim Retkoceri**, tha se ai është materiali që është dorëzuar, tash çfarë mbetet të trajtohet ia lëmë seancës.

**Nora Kelmendi**, tha se po bien në kundërshtim me pikën e rendit të ditës, sepse shiko se çfarë shkruan në pikë të rendit të ditës e çfarë materiali e ka dorëzuar, ka dorëzuar material për dhënie në shfrytëzim të pronave për gjashtë muajt e fundit, e shiko se si është pika e rendit të ditës.

**Bahri Gashi**, tha se Komuna e Prishtinës i ka 40 apo 50 prona në Zonë industriale dhe askush nuk na ka treguar se a paguan dikush prej atyre, janë të gjitha biznese multi milionëshe, e me ardhur me 4 pika të rendit të ditës, kështu që nuk ka kuptim me bërë shaka me 51 asamblistë me 4 pika.

Mos na vendosni në pozitë të keqe, katër prona i keni sjellë, katër prona që nuk kanë kurrfarë rendësie në krahasim me ato që ka rendësi pjesa tjetër e atyre, unë kam pyet për një parking veç ka ardhur që është me koncesion 25 vjet asgjë ma shumë.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

## **Pika e tretë**

**Raportimi për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023**

**Valbona Makolli**, dha sqarime se bartja e mjeteve nga vitit 2022 në vitin 2023, është 51,425,219.16 €, ku prej tyre mjete të pashpenzuara janë 47,273,692.31€, kurse tejkalim të planit të hyra për vitin 2022 janë 4,151,526.85 €.

Në arsyetim e kemi dhënë që tejkalimi i të hyrave vetanake është 1,064,302€, kurse 3,087,224.55 €, janë të hyrat indirekte të cilat kanë ardhur, TM 3 që e bën Ministria e Financave pas mbylljes

së vitit, janë të hyrat nga gjobat e gjykatës si dhe ato të pyjeve, kështu që në total tejkalimi është 4,151,522€.

**Bahri Gashi**, kërkoi nëse ka mundësi numrat e prokurimit që nuk tregojnë vitin e kontratës, për arsyen e mos ta akuzojmë pushtetin aktual për kontrata të mëhershme.

**Valbona Makolli**, tha se të gjitha janë, nuk ka problem e shtoj edhe një rubrikë.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raportimi përbartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023 dhe dërgohet në Kuvend përmiratim.**

#### Pika e katërt

**Propozimvendimi për caktimin e Komisionit përifreskimin e listës rezervë përemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave përemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet**

**Gëzim Sveçla**, tha se nuk qenka askush me na dhënë informacione kam nevojë për disa informacione shtesë, si do të bëhet zgjedhja e përfaqësuesve.

**Fehmi Kupina**, dha sqarime për zgjedhje është kështu: Anëtarë të komisionit e cekur në pikën e parë të këtij vendimi po thotë që duhet me qenë 9 anëtarë, prej 9 anëtarëve nga Kuvendi janë 7 dhe 1 është nga ekzekutivi dhe një nga urbanizmi.

**Gëzim Sveçla**, tha se cila është formula që zgjidhen anëtarët e Kuvendit.

**Leutrim Retkoceri**, dha sqarime se vota e zgjedhjeve të tectorit 2021, rezultati i KQZ-së për Kuvend Komunal në zgjedhjet që kanë qenë sikur në KPF, si ka qenë ajo duhet të shkoj d.m.th përpjesëtohen sa numra janë kush e kalon atë prag edhe kuota gjinore duhet me u marrë parasysh.

Pajtohem me Gëzimin që është mirë me e definuar ne tash që në seancë me qenë gati, sepse duhet me i lajmëruar anëtarët e grupit, e sidomos përfaqësimin gjinor.

**Bahri Gashi**, pyeti a nuk ka njerëz të jashtëm të natyrave të ndryshme që i njohin rrethanat se çfarë duhet të bëjmë.

**Osman Bllaca**, tha se në të kaluarën komisioni është krijuar me përbërje krejt tjetër, në komision normalisht janë edhe të Kuvendit edhe ekzekutivi por kanë qenë të ftuar edhe një historian, një person i trashëgimisë kulturore, një person i institutit albanologjik, një gjuhëtar, sepse ka pas probleme me emërtim të rrugëve, tash nuk e di a ka ndryshuar udhëzimi apo ligji për adresim të adresave atëherë nuk e di si është përbërja.

**Bahri Gashi**, tha se edhe pse paska pasur gjuhëtar ka shumë gabime nëpër rrugët e Prishtinës, me të vërtetë është e dhimbshme ndryshimi i emrave e mbiemrave që kanë ndodhur.

**Leutrim Retkoceri**, tha se unë e kam propozuar në KPF në seancën e kaluar që të hyjë në Plan të punës, është me rëndësi sepse edhe ju edhe ne kemi kërkesa, sot një rrugë e re nëse vjen nuk dihet se si vendoset pa komision e ka një listë rezervë e trajton në mënyrë të barabartë, kur kemi kërkesa i dërgojmë në komision përmes përfaqësuesit dhe komisioni pastaj në bazë të ligjit i vendosë.

**Gëzim Sveçla**, tha se duhej të ishte dikush prej ekzekutivit, kabinetit të kryetarit, apo dikush që na tregon mënyrën, procedurën ne tash nuk po e dimë as procedura se si do të shkojë.

**Nora Kelmendi**, tha se të premten kemi me e votuar vetëm listën rezervë dhe komisionin, sepse nuk mundet të rifreskohet lista rezervë pa komision, do të thotë ne e votojmë komisionin në mënyrë që me hy emra të rinjtë në lista rezervë.

**Gëzim Sveçla**, tha se mua po më duket shumë e logjikshme që në komisionin e kaluar ka pasur edhe gjuhëtar edhe historianë.

**Nora Kelmendi**, tha se me rifreskuar listën rezervë sepse lista kryesore nuk preket.

**Bahri Gashi**, pyeti se ky komision a ka të drejtë ta ndërrojë ndonjë emër të kaluar.

**Fehmi Kupina**, tha se po, sigurisht që do të ketë të drejtë për vetë faktin që po formohet komisioni do të ketë të drejtë.

Është mirë që ne me e zgjedhë komisionin dhe normal që komisionit do t'i bashkëngjiten edhe historianët edhe gjuhëtarët dhe të gjitha profileve.

**Bahri Gashi**, tha se në vendim nuk ishte zgjedhja e kryesuesit.

**Leutrim Retkoceri**, tha se nëse votohet komisioni, komisioni vendosë për kryesuesin e vetë, ne nuk mundemi me ia vendosë kryesuesin komisionit, as Kuvendi.

**Bersant Beka**, tha se dua të bëjë një informim në Kuvend për shkak të zgjedhjeve të këshillave lokal që e kemi mbajt në komisioni dhe dua të japë si informatë që e kemi bërë planin për 2 javë kështu që për çdo ditë kemi me mbajtur zgjedhje nëpër këshilla lokal dhe menduan të jemi më transparent që me qenë korrekt me kolegët që e kanë votuar këtë komision.

**Leutrim Retkoceri**, tha se në përqindje VV-ja i 33.56%, LDK-ja i ka 27.22%, PDK-ja, i ka 17.73%, AAK -ja i ka 10.75%, AKR-ja, i ka 5.59%, LB-ja i ka 2.89% dhe NISMA i ka 0.98%.

**Nora Kelmendi**, pyeti drejtorin këtu dua të pyes se përse i keni larguar nëpër sportele ato përlëvdata të qytetarëve.

**Bersant Beka**, u përgjigj se janë bërë ndryshime nëpër sportele dhe ato kanë me u vendos.

**Gëzim Sveçla**, tha se në bazë të përqindjes VV-ja i ka 2 anëtarë, LDK 2, PDK 1, AAK 1, AKR 1.

**Leutrim Retkoceri**, tha se kuotën gjinore duhet me e caktuar.

**Fehmi Kupina**, tha se e kam një propozim për shembull grupei më i madh i ka 2, një femër një mashkull, LDK-ja vjen pastaj një femër një mashkull.

Ai tha se emrat mund t'i sillni në seancë ose mund t'i dërgoni në email para seancës dhe kështu nuk humbim kohë.

**Nora Kelmendi**, tha se duhet me qenë një femër një mashkull po ashtu tha se Agjensioni Kadastral e ka ekipin që merret me sistem të adresave.

**Leutrim Retkoceri**, tha se e kanë bërë një mbledhje të grupit dhe jemi dakorduar për Muhametin i cili e ka përvojën, i njeh rrugët, e njeh qytetin, i njeh fshatrat më mirë.

**Bahri Gashi**, tha se d.m.th prej 9 personave duhet me qenë 3 femra apo jo.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për caktimin e Komisionit përifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

## Pika e pestë

### Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës 2023-2025

**Adelinë Sahiti**, drejtore tha se Plani i veprimit është iniciuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve më saktësish nga Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare, është një plan i cili për herë të parë po bëhet për Kryeqytetin për këto shërbime që për neve janë kruçiale që të jemi sa më efikas, sa më afër qytetarëve dhe të jenë në mbrojtjen sociale për qytetarët e Komunës së Prishtinës.

Atëherë është edhe matrica është plani i veprimit se si do të funksionojë, se si do të jenë të shpërndara veprimet që ne do t'i bëjmë për qytetarët në nevojë në Kryeqytet.

Ajo që ka shumë rëndësi është që për hartimin e këtij plani është organizuar një komunitet i tërë, kur them komunitet i tërë e kam fjalën tek së pari për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, me kapacitetet e saja të plota, të Qendra për Punë Sociale si institucioni kryesorë ku qytetarët drejtohen për shërbime sociale dhe familjare.

E po ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile janë lehtesuar në aspektin financiarë sepse kemi mbajtur punëtori e takime të shumta. Është shoqata e fëmijëve të cilët kanë ndihmuar jashtëzakonisht që ky plan të ketë formën të cilën sot e ka.

Për ne ka pasur dhe ka shumë rëndësi që ky plan të jetë i jetërsueshëm dhe do të bëjmë të pamundurën, sepse shkon në vijë me strategjinë tonë të drejtorisë për këto vitet sa jemi në mandat.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës 2023-2025 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e gjashtë

### Të ndryshme

**Bahri Gashi**, pyeti për çështjen e pyetjeve që i bëjnë në seanca e që nuk i marrim përgjigjet kurrë, si është si procedurë ajo dhe pyetja tjetër në fillim të mandat Sami Boroci pat kërkuar që të na sigurohen disa zyre, hapësira për të mbajtur takime me qytetarë e më kurrë nuk është diskutuar për atë.

**Fehmi Kupina**, u përgjigj duke cekur se, sa i përket zyrës nuk është që nuk e ka përmendur kryetari, por deri ku ka mbërri nuk e di. Është parapara në katin përdhese me e pas një zyre ju, dhe me qenë një sallë për medie, nuk është që nuk është duke u punuar në atë drejtim, besoj që do të bëhet.

Sa i përket pyetjes që nuk ju është kthyer përgjigjja i drejtohesh drejtorëve, sepse unë në emër të tyre nuk mund të flas nuk jam kompetent.

**Adelina Sahiti**, tha se sa i përket drejtorisë time, kur kanë ardhur pyetje individuale prej asamblistëve unë e ndjej të nevojshme dhe obligim tim njerëzor së pari që me ju përgjigj kështu që sa herë kemi pasur pyetje jemi përgjigjur.

**Fehmi Kupina**, tha se çdo kërkesë që vjen në zyrën time unë menjëherë i përcjelli secilit asamblistë, ose të ndonjë qytetari që më vjen në zyre aty për aty i përcjelli.

**Nora Kelmendi**, tha se a do të diskutojmë rreth pikës së Adhurimit.

**Bahri Gashi**, tha se këtu vjen një ekip që e bën vlerësimin dhe tregon se sa para duhet t'i japim.

**Gëzim Sveçla**, pyeti se në çfarë kodi mundemi me i dhënë mjetet.

**Leutrim Retkoceri**, tha se kryetari e propozon subvencionin, e Kuvendi Komunal e voton.

**Fehmi Kupina**, tha se këtu mund të na ndihmojë drejtoria Valbonë Makolli, nga mund të sigurohen këto mjete.

**Valbona Makolli**, tha se këtë temë do ta diskutojmë me kryetarin.

**Leutrim Retkoceri**, tha se aty tek bartja e mjeteve, tek tabela e lexova që ishin 40 mijë euro për llaptop, këtë që tha Bahriu, zyre, llaptop e të tjera, me i përpjesëtar pér 60 persona, vlera e llaptopëve i bie 666 euro.

Ju lutemi mos na e bëni si mandatin e kaluar, mos tenderoni, mos pranoni, vendosni disa specifika që t'i kemi disa llaptopë që ia vlejnë.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:25.*

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Fehmi Kupina

